



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.511/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zoran Mojsiloviç, nga rradhët e subjektit politik Lista Sërbe (SL) me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik GI SDP të Oliver Ivanoviç, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Zoran Mojsiloviç, nga rradhët e subjektit politik Lista Sërbe (SL) me seli në Mitrovicën e Veriut, me shenjën ZL.Anr.511/2017 e datës 25.10.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 25.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Zoran Mojsiloviç, nga rradhët e subjektit politik Lista Sërbe (SL) me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën ka pretenduar se, gjatë periudhave të 21.10.2017 - 22.10.2017, në rrugën “Sutjeska” në komunën e Mitrovicës së Veriut, aktivistët nga rradhët e subjektit politik GI SDP të Oliver Ivanoviçit kanë mbuluar posterat e subjektit politik Lista Sërbe, me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenin 4 të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 të KQZ-së.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 25.10.2017 në ora 09:20 minuta. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesë ZL.Anr.511/2017 të datës 25.10.2017, ndërlidhet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar në PZAP me datë 25.10.2017, në ora 09:20 minuta, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.511/2017 më datën 25.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.